

Melita&Partners e themeluar në vitin 2010 është kompani lidere në ofrimin e teknologjive të reja në fushën e menaxhimit financiar dhe zgjidhjeve totale për klientë të industrive të ndryshme. Jemi të njohur për ofrim të shërbimeve me vlerë të madhe për klientin, shërbim të përgjegjshëm dhe reputacion të fuqishëm. Me zgjidhjet që ne ofrojmë përmes optimizimit të proceseve të punës, softuerit QuickBooks & moduleve shtesë, trajnimeve dhe përkrahjes së vazhdueshme, klientët tanë ndihen të sigurtë në vendimarrjen e tyre me informacione të sakta dhe në kohë reale. Kështu klienti fokusohet në rritjen dhe menaxhimin e një biznesi të sukseshëm.

Për të përmbushur kërkesat e vazhdueshme të bizneseve për informacione dhe raporte në kohë reale, Melita & Partners ka konceptuar shërbime e reja, të cilat së shpejti do të ofrohen në treg dhe që do të ndihmojnë biznesin drejt transformimit digjital.

Në këtë drejtim Melita & Partners ka ofertë punësimi për 12 vende të lira për profilet:

1) teknik kontabiliteti - 8 vende të lira

2) agjentë të shitjes - 2 vende të lira

3) zhvillues softuerik -2 vende të lira

Detajet e përgjithshme:

1) Teknik kontabiliteti

2) Agjentë të shitjes

Për kandidatët që kualifikohen për pozitat 1) dhe 2) ofrohet trajnim falas në QuickBooks me certifikim ndërkombëtar (QBCU), në formë të trajnimit në bllok me ushtrime dhe projekte praktike si dhe me ofertë punësimi pas përfundimit të suksesshëm të trajnimit dhe certifikimit.

Trajnimi është intensiv për një muaj, që nënkupton angazhim me orar të plotë gjatë ditëve të punës (e hënë-e premte). Gjatë kësaj kohe do të ketë trajnime dhe ushtrime praktike në përdorimin e QuickBooks.

Trajnimet mbahen nga këshilltar të certifikuar në QuickBooks, kontabilist të certifikuar me përvojë të gjerë praktike në kontabilitet dhe QuickBooks.

Trajnimi mbahet në gjuhën shqipe, kurse materialet janë në gjuhën angleze dhe testi i certifikimit është në gjuhën angleze.

Kandidatët do të mbështeten nga mentorë profesionistë gjatë gjithë trajnimit

Kandidatët do të punojnë në detyra konkrete të lidhura me materien e mësuar

Kandidatët do të punojnë në ekip për raste studimi dhe do të ushtrojnë rolet përkatëse

Kërkesat specifike

1) Teknik kontabiliteti:

- Të ketë të përfunduar fakultetin ekonomik, drejtimi kontabilitet, banka dhe financa
- Të jetë student apo teknik i certifikuar pranë SCAAK (e dëshirueshme)

2) Agjent i shitjes:

- Të ketë të përfunduar fakultetin ekonomik, drejtimi marketing, administrim biznesi ose ekuivalent
- Shkathësi në komunikim, negociim dhe i vëmendshëm në detaje,
- Shkathësi në prezentim
- I orientuar në rezultate dhe arritje të targetave

3) Zhvillues Softuerik – 2 vende të lira

- Përvojë 2+ vite në zhvillimin e aplikacioneve web, mobile, cloud dhe aplikacione biznesi;
- Përvoje pune 2+ në JAVA dhe C#;
- Përvojë pune në databaza relacionale;
- Diplomë në shkenca kompjuterike apo gati per diplomim;
- Të kuptoj dhe të ketë përvojë në tërë ciklin e zhvillimit softuerik;

Aftësi të dëshiruara

- Aftësi ne Spring Framework ose Jakarta EE (Java EE)
- Certifikime në ndonjërin nga fushat si: Java, C#, Databaza, HTML dhe CSS.
- Aftësi në JavaFx dhe Swing.

Kërkesat e përgjithshme për të gjitha pozitat

Rezultate të mira gjatë studimeve me notë mesatare mbi 8.5

Pasion dhe dëshirë për mësim dhe për të bërë ndryshimin

Përkushtim dhe obligim për pjesëmarrje të rregullt në trajnim (e domosdoshme)

Shkallë të lartë të iniciativës, përgjegjësisë, kreativitetit dhe vullnetit krijues

Njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze në lexim, shkrim dhe komunikim

Të ketë patent shoferi kategori B me përvojë në vozitje (e dëshirueshme)

Matja e rezultatit dhe vlerësimi

Kandidatët do të maten në performansë dhe do të vlerësohen gjatë gjithë trajnimit në fushat përkatëse

Kandidatët duhet të certifikohen në QuickBooks (për pozitat 1 dhe 2)

Kandidatët duhet të tregojnë interesim të dalluar dhe të kontribuojnë në grup

Çka mund të prisni?

Mundësi punësimi pas rezultateve të dalluara në trajnim

Mundësi zhvillimi profesional dhe personal me zhvillim karriere

Përfitim nga përvoja profesionale e një kompanie lidere në treg

Klimë pune e hapur, motivuese dhe e orientuar në punë ekipore

Projekte interesante nga fusha të ndryshme

Mundësi të jeni pjesë e historisë së transformimit digjital në Kosovë

Për të aplikuar dërgoni email në info@melita-partners.com duke bashkangjitur:

Letër motivuese për pozitën që aplikoni;

CV-në tuaj të përditësuar (me referenca nga përvojat e deritanishme me detaje kontaktuese)

Afati i fundit për aplikim është 12/04/2019.